



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 175/3 Prot.

Tiranë, më 02.03.2026

V E N D I M

Nr. 48, Datë 02.03.2026

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa nr. 24, datë 20.01.2026¹, e bërë nga shtetasi G.E.I.H kundër punëdhënësit “AFerhati” shpk², në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “racës” dhe “ngjyrës”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës, subjekti ankues, në mes të tjerash informon se: “Unë, G.H, shtetas egjiptian, mbajtës i lejes së qëndrimit nr. 3xxx, paraqes këtë ankesë kundër punëdhënësit tim për shkelje të rënda të të drejtave të mia ligjore dhe njerëzore.

Punëdhënësi, M, telefon 068xxxxx, po ushtron presion të vazhdueshëm ndaj meje me qëllim largimin tim nga Republika e Shqipërisë pa asnjë arsye ligjore, si dhe refuzon të më dorëzojë pasaportën time, duke e mbajtur atë në mënyrë të paligjshme.

Mbajtja e pasaportës sime përbën shkelje të rëndë ligjore, cenon lirinë time personale dhe më vendos në një gjendje pasigurie të plotë. Për më tepër, jam kërcënuar me dëbim, pa vendim

¹ Ankesa është plotësuar me informacionin dhe dokumentacionin e dërguar me email-in datë 28.01.2026.

² Rregjistruar ne QKB, me NUIS M3xxxxxxJ, me emrin e subjektit: AFerhati shpk.

zyrtar nga autoritetet kompetente dhe pa bazë ligjore, gjë që përbën abuzim me pozitën e punëdhënësit dhe shkelje të të drejtave të punonjësit të huaj”.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit, kthimin e pasaportës dhe ndërprerjen e çdo forme presioni apo kërcënimi ndaj tij.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.*

Në nenin 3/1, të LMD parashikohet se: *““Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.*

Bazuar në nenin 7, pika 1, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohej ndaj çdo veprimi ose mosveprimi të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë, që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Mbështetur në detyrimet ligjore të parashikuara në nenin 3 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë në të cilën shteti merr masa për mbrojtjen e dinjitetit të njeriut dhe respektimin e lirive dhe të drejtave të tij, nenit 14 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, ligjin 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi synon respektimin me rigorozitet të parimit të barazisë përpara ligjit, barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat dhe liritë, si dhe zbatimin e efektshëm të politikave antidiskriminuese.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

- Me shkresën nr. 175/1, datë 05.02.2026, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka njoftuar dhe kërkuar parashtrime nga subjekti “AFerhati” shpk, lidhur me pretendimet e subjektit ankues.

Me email-in datë 19.02.2026, subjekti “AFerhati” shpk, në mes të tjerash informoi se: “Z. G.H i është tërhequr vëmendja gjithë kohës për sjellje të pahijshme që ka treguar ndaj klientëve dhe stafit të punës. Z. G ka pasur konfrontim me duar me njerëz të stafit (jo personi që ka cituar). Pasi i është tërhequr vëmendja me muaj me radhë, vendosëm që të prishim kontratën dhe i premë biletën e kthimit (datë 20.01.2026). Gjatë kësaj kohe kemi njoftuar agjencinë që është marrë me procedurat e punësimit të z. G, Zyrën e Punës, si dhe Zyrën e Emigracionit. Pasaporta është mbajtur nga Zyra e Emigracionit dhe për këtë arsye nuk i është dorëzuar z. G, kur e ka kërkuar. Pjesa që ka përmendur ngjyrën dhe racën nuk është aspak e vërtetë, sepse ne si subjekt nuk kemi bërë asnjë sjellje të pahijshme kundrejt tij dhe asnjë pjesëtar tjetër të stafit. Është respektuar dhe është paguar për të gjitha ditët e punës që ka qëndruar tek ne, përfshirë dietat ushqimore.

Ne kemi 3 persona të tjerë të huaj të punësuar dhe asnjëherë nuk kemi patur probleme dhe kemi një marrëdhënie shumë të mirë me znj. J.B, në pozicionin sanitare, z. M.M, në pozicionin e llamarinistit të automjeteve dhe z. M.I, në pozicionin si bojaxhi për automjetet”.

Në zbatim të parimit të kontradiktoritetit e transparencës, për një gjykim sa më të drejtë të çështjes, ankuesi nëpërmjet e-mail-it datë 19.02.2026, është njohur me përgjigjen e subjektit “AFerhati” shpk.

Në vijim, subjekti ankues, nëpërmjet email-it datë 19.02.2026, ka kërkuar tërheqjen nga ankesa, duke informuar se: “Në vijim të mesazhit tuaj, ju bëj me dije se jam dakord me përgjigjen e dhënë nga subjekti “AFerhati” shpk dhe e pranoj raportin e tyre si të vërtetë. Përmes këtij komunikimi, kërkoj zyrtarisht tërheqjen dhe mbylljen e ankesës sime ndaj këtij subjekti. Nuk dëshiroj që kompania të përballet me asnjë problem apo procedurë të mëtejshme në lidhje me këtë çështje”.

Në nenin 32, pika 3, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar përcaktohet: “3. Për shqyrtimin e ankesave që i drejtohen, Komisioneri zbaton normat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative, me përjashtim të procedurave që parashikohen nga ky ligj”.

Në nenin 90/3 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, parashikohet se: “Procedura administrative, e nisur me kërkesë apo kryesisht, deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar për çështjen, në rastet e parashikuara në nenet 93-96 të këtij Kodi. Deklarata e përfundimit të procedurës administrative, pa një vendim përfundimtar për çështjen, përbën akt administrativ”.

Në nenin 94³/1 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, parashikohet se: “Si rregull, në procedurën administrative të nisur me

³ “Tërheqja e ankesës”.

kërkesë, organi publik deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë”.

Procedura administrative konkrete pranë Komisionerit, është iniciuar mbi bazën e ankesës së paraqitur nga subjekti ankues, z. G.H i cili me anë të kërkesës të përcjellë nëpërmjet email-it datë 19.02.2026, është tërhequr nga ankesa pranë KMD-së.

Bazuar në dispozitat e mësipërme ligjore, si dhe kërkesën për tërheqje nga ankesa e paraqitur nga subjekti ankues në datën 19.02.2026, Komisioneri vlerëson se, procedura për shqyrtimin e ankesës nr. 24, datë 20.01.2026, e paraqitur nga z. G.H kundër Shoqërisë “AFerhati” shpk, nuk mund të vazhdojë, por duhet të deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar, për shkak se subjekti ankues është tërhequr nga ankesa.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 90/3 dhe 94/1 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, nenin 32, pika 1, shkronja “a” dhe nenin 33, pika 1, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Të deklarojë të përfunduar procedurën administrative për shqyrtimin e ankesës nr. 24, datë 20.01.2026, të z. G.E.I.H kundër Shoqërisë “AFerhati” shpk, për arsye se subjekti ankues është tërhequr nga ankesa pranë KMD-së.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA